



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prefekti Qarkut Fier

Nr. 144 Prot.

Datë, më 02/02/2026

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 3221/13 Prot.

Fier, më 29/01/2026

Lënda : Rikërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e Sekuestros)

PREFEKTIT TË QARKUT - FIER

Duke vlerësuar me kënaqësi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve tona, në bashkërendimin e veprimeve për zgjidhjen e problemeve të dyanëshme, si dhe me synimin e përmbushjes së misioneve tona të ngarkuara nga Ligji, e shohim të domosdoshëm forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, pasi nga ana jonë konstatohet se në shume raste nëpërmjet Tij, është mundësuar shlyerja e borxhit doganor.

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 48/4 i Tij “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve” - “*Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre*”, në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, neni 131 i Tij “*Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale....*”, nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - “*Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet*”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.3.b e Tij, “*Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar,*

njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim....si dhe në vende publike si në Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”. kërkojmë nga ana Juaj :

♦ “Shpalljen Publike” për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të tre akteve administrativ – Vendimet për rikuperimin me forcë të detyrimit doganor (vendimi i sekuestros) si vijon :

- Nr.3221/9 Prot., datë 16/12/2025, i materializuar për subjektin “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, me seli në Lushnjë (Lagjia Karbunare e poshtëme, Zona Kadastrale Nr.2087, Nr.656/12).

- Nr.3246/11 Prot., datë 16/12/2025, i materializuar për subjektin “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, me seli në Fier (Lagjia “Kryengritja e Fierit”, (Truall+Ndertese)ish U.M.B me nr.Pasurie 8/133, ZK 8531).

- Nr.4138/5 Prot., datë 16/12/2025, i materializuar për subjektin “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Lushnjë (Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1).

Bashkëngjitur, gjeni kopje të tre akteve të lartcituara - gjithsej 3 (tre) fletë.

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes publike të tre akteve të lartpërmendur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 3221/9..... Prot.

Fier, më 16/12/2025

V E N D I M

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore që debitori - subjekti “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, me seli në Lushnjë, ka ndaj Degës së Doganës Fier”.

Dega e Doganës Fier, me Vendimin e saj Nr.100, me Nr.3221/4 Prot., datë 30/10/2025, ka vendosur kontabilizimin e penalitetit doganor në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, me seli në Lushnjë (Lagjia Karbunare e poshtëme, Zona Kadastrale Nr.2087, Nr.656/12), me administrator z.Fatmir Taraj, me status në Q.K.B “Aktiv”.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.3221/5 Prot., datë 07/11/2025, me lëndë “Njoftim - Vendimi”, me anë të njoftimit elektronik me email-in e datës 12/11/2025 me lëndë “Njoftim i aktit administrativ – Vendimit të kontabilizimit të penalitetit doganor nr.100, me nr.3221/4 Prot., dt.30/10/2025”, si dhe me anë të lajmërimit publik.

Gjithashtu, me shkresën nr.3221/7 Prot., datë 20/11/2025, me lëndë “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore” Dega e Doganës Fier i ka kërkuar subjektit ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore.

Personi juridik debitor “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr. 100, me Nr.3221/4 Prot., datë 30/10/2025, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.100, me Nr.3221/4 Prot., datë 30/10/2025, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, ka ndaj Degës Doganore Fier, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe

Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik “CARTOTECNICA TOSCANA” sh.p.k, me NUIS M14724401K, i ka Degës së Doganës Fier, në shumën totale **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr.100, me Nr.3221/4 Prot., datë 30/10/2025, të Degës së Doganës Fier.

K R Y E T A R

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 3246/..... Prot.

Fier, më 16/12/2025

V E N D I M

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore që debitori - subjekti “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, me seli në Fier, ka ndaj Degës së Doganës Fier”.

Dega e Doganës Fier, me Vendimin e saj Nr.101, me Nr.3246/5 Prot., datë 30/10/2025, ka vendosur kontabilizimin e penalitetit doganor në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, me seli në Fier (Lagjja “Kryengritja e Fierit”, (Truall+Ndertese)ish U.M.B me nr.Pasurie 8/133, ZK 8531), me administrator z.Paolo Rosafio, me status në Q.K.B “Aktiv”.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.3246/7 Prot., datë 07/11/2025, me lëndë “Njoftim - Vendimi”, me anë të njoftimit elektronik me email-in e datës 12/11/2025 me lëndë “Njoftim i aktit administrativ – Vendimit të kontabilizimit të penalitetit doganor nr.101, me nr.3246/5 Prot., dt.30/10/2025”, si dhe me anë të lajmërimit publik.

Personi juridik debitor “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.101, me Nr.3246/5 Prot., datë 30/10/2025, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.101, me Nr.3246/5 Prot., datë 30/10/2025, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “SILVER BLU Production” sh.p.k, me NUIS M22724402P, ka ndaj Degës Doganore Fier, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”,

VENDOSA:

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik "SILVER BLU Production" sh.p.k, me NUIS M22724402P, i ka Degës së Doganës Fier, në shumën totale **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr.101, me Nr.3246/5 Prot., datë 30/10/2025, të Degës së Doganës Fier.

KRYETAR

Kosta Vjero





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 4198/5.... Prot.

Fier, më 16/12/2025

V E N D I M

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimeve Doganore që debitori - subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Fier, ka ndaj Degës së Doganës Fier”.

Dega e Doganës Fier, me Vendimin e saj Nr.102, me Nr.4198/1 Prot., datë 30/10/2025, ka vendosur kontabilizimin e penalitetit doganor në shumën **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, me seli në Fier (Lushnjë, Rruga e Plugut, ish Ofiçina Plug, Magazina Nr 1), me status në Q.K.B “Aktiv”.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.4198/3 Prot., datë 07/11/2025, me lëndë “Njoftim - Vendimi”, me anë të njoftimit elektronik me email-in e datës 12/11/2025 me lëndë “Njoftim i aktit administrativ – Vendimit të kontabilizimit të penalitetit doganor nr.102, me nr.4198/1 Prot., dt.30/10/2025”, si dhe me anë të lajmërimit publik.

Personi juridik debitor “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.102, me Nr.4198/1 Prot., datë 30/10/2025, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.102, me Nr.4198/1 Prot., datë 30/10/2025, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “SIBCO” sh.p.k, me NUIS M24203402O, ka ndaj Degës Doganore Fier, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *“Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”*,

VENDOSA:

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "SIBCO" sh.p.k, me NUIS M24203402O, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "SIBCO" sh.p.k, me NUIS M24203402O, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik "SIBCO" sh.p.k, me NUIS M24203402O, i ka Degës së Doganës Fier, në shumën totale **50,000** (Pesëdhjetëmijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr.102, me Nr.4198/1 Prot., datë 30/10/2025, të Degës së Doganës Fier.

KRYETAR

Kosta Vjero

